



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

GODIŠNJI IZVEŠTAJ PERFORMANSE

ANNUAL PERFORMANCE REPORT

//2014//



Prishtinë, Prill 2015



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

//2014//

Prishtinë, Prill 2015



FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar Kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mandati i Auditorit të Përgjithshëm ka përfunduar në fund të muajit gusht të vitit 2014. Unë, si ushtrues detyre i Auditorit të Përgjithshëm ju dorëzoj Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2014.

Autoritetet publike janë përgjegjëse për mënyrën se si i përdorin burimet dhe kompetencat publike. Është punë e Auditorit të Përgjithshëm për të dhënë siguri të pavarur Kuvendit dhe të qytetarëve për mënyrën se si japin llogari për financat dhe performancën e tyre.

Raporti fokusohet në mënyrën se si Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka përdorur burimet që i janë besuar gjatë kohës së presionit financiar për Qeverinë e Kosovës. Raporti përmbledh rezultatet e arritura dhe mundëson një krahasim me vitet e mëparshme buxhetore. Më e rëndësishmja, raporti thekson veprimet që kemi marrë dhe do të vazhdojë të marrë për tu përgjigjur sfidave që dalin si për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm ashtu dhe për sektorin e gjerë publik.

Qytetarët dhe përfaqësuesit e tyre duhet të kenë pritshmëri të mëdha nga Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Puna e auditimit duhet t'i ofrojë vlerë autoriteteve publike, të cilat përballen me presione financiare dhe operative. Ato duhet të presin përkrahje konstruktive përmes auditimeve tona dhe rekomandimeve praktike në raportet tona.

Ndërkohë që kërkojmë të bëhemi një Institucion Suprem i Auditimit, i cili performon mirë, ne duhet:

➤ Të fokusohemi kah e ardhmja për të njohur dhe



adresuar çështjet me ndikim më të madh me të cilat përballen autoritetet publike;

- Të sfidojmë entitetet e audituara për mënyrën se si vepron dhe të japim reagime konstruktive, praktike dhe këshilla specifike për atë që ato mund të bëjnë më mirë; dhe
- Të diskutojmë për mënyrën se si autoritetet publike mund të identifikojnë dhe zbatojnë me më shumë efikasitet praktikatat më të mira që auditorët shohin në organizata të tjera.

Në të njëjtën kohë ne duhet të konsiderojmë:

- Gamën e auditimit, mjetet e vlerësimit si dhe aftësitë e nevojshme të stafit për të maksimizuar ndikimin tonë në përmirësimin e performancës në sektorin publik, derisa zhvillojmë edhe fushëveprimin e punës sonë të auditimit duke minimizuar bërthamën e 'opinionit të auditimit'; dhe
- Se si ti bëjmë shërbimet tona që të jenë aq fleksibile sa për t'iu përshtatur një ambienti që ndryshon me shpejtësi dhe mjaft të veçantë, duke ekuilibruar presionet e vlerës për para dhe afateve kohore me rishikimet gjithëpërfshirëse dhe angazhimin efektiv.

Përkundrejt këtij sfondi unë do të doja të nxirrja në pah çështjet që lidhen me rolin e Auditorit të Përgjithshëm dhe qeverisjen.

Shpesh e shoh rolin dhe përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm si të ekzagjeruar. Opinioni i Pamodifikuar i Auditimit shpesh përshkruhet si marrje e "vulës së miratimit", "një po e madhe", apo si "kontroll me

rezultate të mira". Ajo çka ofron opinionin i pamodifikuar është siguria e pavarur se informacionet financiare (dhe informata tjera të performancës) raportohen në mënyrë të drejtë dhe se mund të mbështetemi mbi to. Nuk është një deklaratë e përgjithshme për qeverisjen e organizatave. Kjo është përgjegjësi e menaxhmentit, të cilët duhet të zbatojnë aranzhimet efektive të menaxhimit të rrezikut mbështetur nga vetë-vlerësimet realiste dhe raportimet me cilësi të lartë. Njësitë e auditimit të brendshëm duhet të aplikojnë plane gjithëpërfshirëse të auditimit të cilat ofrojnë siguri ose ndryshe në funksionimin e sistemeve kryesore të informacionit financiar dhe të tjera. Rritja e fokusit tonë në çështjet e qeverisjes synon të mbështesë zhvillimet në këto fusha.

Duke pasur parasysh të kuptuarit e këtyre roleve themelore është e rëndësishme që mbikëqyrja parlamentare të funksionoj si duhet. Viti 2014 ka qenë një vit i humbur në këtë drejtim. Viti 2015 ofron një mundësi për një mekanizëm mbikëqyrjeje shumë të përforcuar dhe është e rëndësishme të marrim në konsideratë se cila duhet të jetë baza e informacioneve për këtë.

Kontabiliteti aktual do të ndihmonte menaxhimin më të mirë të ekonomisë duke zbuluar shtrirjen e plotë të pasurive dhe detyrimeve të qeverisë në kohë dhe do të ndihmonte në shmangien e shpenzimeve të padëshirueshme duke rritur besimin e publikut në menaxhimin financiar. Një përfitim tjetër është edhe transparenca.

Perceptimi i vërtetë për qëndrueshmërinë financiare vjen nga të kuptuarit e marrëdhënieve mes performancës financiare dhe asaj operative përmes analizës së informacionit financiar të audituar. Së bashku me informacionin e performancës operative, ne mund të nxjerrim në pah pasojat afatgjata të pozitës financiare të reflektuar në Pasqyrat Vjetore Financiare dhe rreziqet për performancën operative. Si e tillë, përdorimi i hershëm i kontabilitetit aktual do të jetë me dobi të konsiderueshme për Kosovën.

Gjatë hartimit dhe përdorimit të pasqyrave financiare, ne duhet ta vëmë veten në pozitën e përdoruesve të informacionit. Nga ky këndvështrim, u bëj lutje të gjithëve që të vazhdojnë të punojnë për raportim më të thjeshtë dhe informacion të integruar. Shumë shpesh, rregulla tepër të ngurta dhe/ose mendime fikse minojnë informacionin kuptimplotë dhe konciz, i cili mund të përmirësojë ekzaminimin e autoriteteve publike. Unë nuk pajtohem me idenë 'sa më shumë informacion të keq aq më mirë është'. Informacioni duhet të jetë i përshtatshëm për përdoruesit e tij. Më sfiduese është bërja e informacionit më të dobishëm

për shumë grupe të interesit dhe individë që përbëjnë "publikun".

Ka shumë mundësi që auditorët e jashtëm të ofrojnë vlerë. Por, kërkimi për të siguruar vlerën për para do të sfidojë Auditorin e Përgjithshëm (dhe autoritetet publike) në të ardhmen e parashikueshme. Analiza e fuqishme, e mbështetur nga teknologjia, do të na ndihmojë që të analizojmë më mirë grupet e pasura të të dhënave dhe të ndajmë atë që dimë për autoritetet publike. Media sociale është duke i rritur lidhjet dhe mënyrat se si njerëzit komunikojnë. Kjo do të na ndihmojë që edhe ne të ndajmë bashkë me një gamë të gjerë të njerëzve dhe me audiencën gjëra që kanë rëndësi për ta në sektorin publik. Ne kemi filluar të eksplorojmë mënyra të ndryshme për të komunikuar mesazhet tona. Këto kanale vazhdimisht evoluojnë. Përvojat ndërkombëtare duhet të merren parasysh.

Sipas ligjit, Auditori i Përgjithshëm është auditor statutor vjetor i rreth 90 autoriteteve publike në Kosovë, të cilat obligohen të përgatisin Pasqyra Vjetore Financiare si dhe ka autoritetin për të kryer forma të tjera të auditimit nëpër pothuajse të gjithë sektorin publik. Asnjë organizatë tjetër, publike apo private, nuk ka të njëjtën pikëpamje të sektorit publik, e cila neve na vë në një pozicion unik për të ndihmuar në përmirësimin e performancës.

Kohërat e ndryshimeve janë kohëra të mundësive - pavarësia, integriteti dhe vlera për para janë shtylla kurrizore e punës së auditorit. Drejtimi, të cilin duhet ta marrim, është i qartë.

Mundësia qëndron në mënyrat e shumta dhe të ndryshme, dhe ne potencialisht mund të ofrojmë më shumë vlerë për publikun dhe përfaqësuesit e saj.

Vizioni ynë është që të bëhemi institucion publik i auditimit të jashtëm i cili në mënyrë të qëndrueshme zbaton plotësisht standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikën e mira evropiane.

Menaxhimi i ndryshimit të vazhdueshëm, qasja e orientuar kah rezultatet, bashkëpunimi konstruktiv dhe dialogu i fortë me palët tona kryesore të interesit për buxhetin janë një kërkesë në përmbushjen e këtyre ambicieve.

Prishtinë, 30 prill 2015



Artan Venhari
Ushtrues detyre i Auditorit të Përgjithshëm

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----------|
| FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM | 5 |
|--|----------|

| | |
|-----------------------------|----------|
| TABELA E PËRMBAJTJES | 7 |
|-----------------------------|----------|

| | |
|---------------------------------------|-----------|
| 01. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS | 10 |
|---------------------------------------|-----------|

| | |
|------------------------------------|-----------|
| 02. TREGUESIT E REZULTATEVE | 12 |
|------------------------------------|-----------|

| | |
|------------------------|----|
| 2.1 Mbulimi me auditim | 12 |
|------------------------|----|

| | |
|------------------------------|----|
| 2.2 Cilësia e raporteve tona | 14 |
|------------------------------|----|

| | |
|-------------|----|
| 2.3 Ndikimi | 15 |
|-------------|----|

| | |
|---|----|
| 2.4 Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm | 17 |
|---|----|

| | |
|---|----|
| 2.5 Rekomandimet nga auditorët tanë jashtëm | 18 |
|---|----|

| | |
|--------------------|-----------|
| 03. BURIMET | 19 |
|--------------------|-----------|

| | |
|------------------------|----|
| 3.1 Burimet Financiare | 19 |
|------------------------|----|

| | |
|--------------|----|
| 3.2 Pasuritë | 21 |
|--------------|----|

| | |
|-----------------------|----|
| 3.3 Burimet Njerëzore | 22 |
|-----------------------|----|

| | |
|-------------------------|-----------|
| 04. BASHKËPUNIMI | 25 |
|-------------------------|-----------|

| | |
|---------------|----|
| 4.1 Projektet | 26 |
|---------------|----|

| | |
|------------|----|
| 4.2 Rrjeti | 27 |
|------------|----|

| | |
|------------------------------|-----------|
| 05. FOKUSI I ARDHSHËM | 28 |
|------------------------------|-----------|

| | |
|--------------------------------|-----------|
| 06. LLOGARIDHËNIA E ZAP | 30 |
|--------------------------------|-----------|

| | |
|---|----|
| SHTOJCA 1: Parathënie e shkurtër për zyrën e auditorit të përgjithshëm | 31 |
|---|----|

| | |
|--|----|
| SHTOJCA 2: Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2014 dhe adresimi i rekomandimeve për vitin 2013 | 34 |
|--|----|

| | |
|--|----|
| SHTOJCA 3: Opinioni i Auditorit të Jashtëm për vitin 2014 | 48 |
|--|----|



SHKURTIMISHT RRETH ZAP

MISIONI

Misioni ynë është të "kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar të administratës publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në pajtim me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikatat e mira Evropiane. Ne do të krijojmë besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit përmes rritjes së llogaridhënies publike"

VIZIONI

Vizioni ynë është që të kemi në vend një Institucionin Suprem të Auditimit (ISA), Zyrën Kosovare Kombëtare të Auditimit, të zotëruar plotësisht nga kosovarët dhe e konsideruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe palët vendor të interesit si një ISA që vepron mirë.

SI VEPROJMË?

Perspektiva jonë e auditimit të jashtëm ndihmon Kuvendin që të kërkojë llogari nga Qeveria dhe të përmirësojë shërbimet publike. Ne auditojmë pasqyrat vjetore financiare të të gjitha organizatave buxhetore për të përcaktuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat janë aprovuar. Përveç kësaj, ne kryejmë auditime jo statutorë me synim përmirësimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre me kosto efektive.

Ne jemi të dedikuar që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë entitetet tona të audituara që të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit përmes rekomandimeve praktike dhe konstruktive, duke i shtuar kështu vlerë veprimtarive të tyre operative dhe strategjike. Ne punojmë ngushtë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike për të vlerësuar vlerën për para që arrihet përmes shërbimeve publike.

Ne jemi të dedikuar që të ndihmojmë në implementimin dhe zhvillimin e qeverisjes së mirë në Administratën Publike duke iu përgjigjur pritshmërive për të dhënë këshilla të duhura.

BAZA

Baza jonë për funksionim administrativ dhe operativ jepet në detaje tek Shtojca 1.

01.

PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

Ne kemi trajtuar sfidat operative dhe administrative pas përfundimit të kontratës së ish-Auditorit të Përgjithshëm në fund të gushtit 2014. Ne ruajtëm fokusin mbi rezultatet dhe zhvillim cilësinë në veprimet tona.

Sezoni i auditimit 2013/14 ka përfunduar në fund të gushtit të vitit 2014. Ne raportuam 102 auditime në total:

- Raportin statutor të auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte statutorë në kuadër të BK-së;
- Nëntë auditime jo-statutorë; dhe
- Katër auditime të fondeve të donatorëve.

Sezoni i auditimit 2014/15 ka filluar në shtator të vitit 2014 dhe planifikojmë të raportojmë 118 auditime:

- Raportin statutor të auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte statutorë në kuadër të BK-së;
- Tetëmbëdhjetë auditime jo-statutorë; dhe
- Njëmbëdhjetë auditime të fondeve të donatorëve.

Asistimi në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe MFP-së

- Zhvillimi pozitiv në mbikëqyrjen parlamentare kishte ndaluar për shkak të fushatës së zgjedhjeve dhe ngërçit politik i cili pasoi. Për shkak të kësaj, ne përqendruam burime shtesë për të përcjellë se si janë adresuar rekomandimet tona të auditimit. Zhvillim pozitiv është vërejtur; dhe

Konkluzionet tona të auditimit dhe rekomandimet e ndërlidhura kanë mbështetur intervenimet me degën e ekzekutivit dhe projektet e ndryshme në fushën e MFP-së në mënyrë aktive duke krijuar një bazë të shëndoshë për qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie. Shembuj të kësaj janë kontributet në ndryshimet strategjike në sektorin e shëndetësisë; një dokument diskutimi rreth përdorimit të indikatorëve të performancës në komuna; pjesëmarrja në Komisionin Drejtues të projektit të PIP-it; komentet për draft strategjinë e KBFP-së; një draft strategji për prokurim dhe një draft plan veprimi për PEFA; hartimi i pjesëve të një manuali dhe trajnimit për hetuesit financiarë, etj.



Modernizimi i Qeverisjes korporative

- Ne kemi zbatuar Strategjinë dalëse të Auditorit të Përgjithshëm dhe kemi filluar me përgatitjen e një platforme të re teorike dhe praktike për Auditorin e ri të Përgjithshëm;
- Për sezonin e auditimit 2014/15 është bërë një ri-organizim i brendshëm i organizatës sonë në mënyrë që të përputhet qartazi me linjat e llogaridhënies brenda fushave të politikës dhe prioriteteve që ndërlidhen me agjendën evropiane;
- I gjithë stafi jonë ka arritur të kuptojë më mirë bazën, kontekstin dhe teknikat e auditimit modern në sektorin publik përmes zbatimit të programit të ri të certifikimit për auditorët e sektorit publik;
- Ne kemi pozicionuar veten si partnerë në forume të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe evropian në mesin e Institucioneve Supreme të Auditimit; dhe
- Ne kemi stimuluar profesionalizmin dhe efikasitetin si dhe kemi futur në funksion mjete dhe instrumente reja për të zhvilluar edhe më tej fokusin dhe një qasje të orientuar kah rezultatet.

Llogaridhënia

- Ne kemi dorëzuar Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2013 me kohë, megjithatë ky raport nuk është diskutuar as nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e as nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Kjo për shkak të shpërbërjes së hershme të Kuvendit në fillim të majit të vitit 2014 dhe ngërçit politik i cili pasoi.

02.

TREGUESIT E REZULTATEVE

Më poshtë janë përmbledhur rezultatet e aktiviteteve tona të matura përmes treguesve sasi-or dhe cilësor, të cilët mundësojnë krahasimin ndër vite dhe sezone të auditimit:

2.1 Mbulimi me auditim – aspekti i madhësisë së Buxhetit të Kosovës (BK) që mbulohet me auditimet statutorë dhe numrin e raporteve të auditimeve tjera të finalizuara;

2.2 Cilësia e auditimeve dhe raporteve – numri i auditimeve të përfunduara dhe raporteve të publikuara që i nënshtrohen Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë;

2.3 Ndikimi – numri i takimeve të mbajtura nga KMFP për rishikimin e raporteve tona, nivelin e rekomandimeve tona të adresuara nga entitetet e audituara dhe konkluzionet në opinione të auditimit; dhe

2.4 Vlerësimet e jashtme dhe të brendshme – nga partnerët tanë të jashtëm dhe të brendshëm për performancën tonë organizative dhe besueshmërinë e punës tonë.

2.1 MBULIMI I AUDITIMIT

Në përputhje me mandatin tonë të auditimit, ne kryejmë si auditime statutorë¹ ashtu edhe

auditime jo-statutorë². Auditimet statutorë të rregullsisë kryhen dhe raportohen në një afat të qartë kohor, me memorandumë të ndërmjetme të prodhuara në dhjetor të vitit 2014 para finalizimit të raporteve vjetore të auditimit në mes të vitit 2015. Auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 mbulon të gjitha organizatat buxhetore, përveç Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI)³, që përfaqëson 100% të të hyrave totale dhe 99% të shpenzimeve totale të BK-së.

Raporti Vjetor i Auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës për vitin 2013 është përgatitur duke u bazuar në të gjeturat nga auditimet individuale, dhe është dorëzuar në Kuvend në fund të gushtit të vitit 2014. Raporti Vjetor i Auditimit është diskutuar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mars të vitit 2015, i cili ka përgatitur edhe një listë rekomandimesh.

¹ Ne i referohemi auditimeve statutorë si auditime të rregullsisë pasi ato përfshijnë auditimin e pasqyrave financiare dhe të pajtueshmërisë.

² Auditimet jo-statutorë përfshijnë auditime të performancës, menaxheriale ose të sistemit dhe nuk kanë kufizime kohore ligjore për dorëzimin e tyre.

³ AKI është subjekt i një regjimi të veçantë auditimi sipas ligjit për këtë agjenci.

Auditimet jo-statutore raportohen në vazhdimësi. Ne kemi rritur në mënyrë progresive mbulimin e auditimeve jo-statutore dhe atyre të fondeve të donatorëve. Krahas kësaj, theksi është vënë në përmirësimin e cilësisë dhe fokusit të të gjitha auditimeve.

Si auditimet statutore ashtu edhe ato jo-statutore mbështesin llogaridhënien në kuadër të procesit të shpenzimeve buxhetore.

Numri i raporteve të auditimit

Në fund të sezonit të auditimit 2013/2014 kemi publikuar 102 raporte të auditimit:

- Raportin e Auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK-së;
- Nëntë auditime të Performancës: Një dokument diskutimi për Indikatorët e Performancës në Komuna për vitin 2013; Mbikëqyrja e zbatimit të Marrëveshjes PPP të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës; Kompensimet për Bordet e Drejtorëve të NP-ve Qendrore; Menaxhimi i përdorimit të automjeteve zyrtare; Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli në Agjencinë e Statistikave; Menaxhimi Financiar dhe Kontrollet në Zubin Potok; Sistemi i Menaxhimit të Mbeturive Komonale; Procesi i buxhetit për skemat pensionale dhe sociale; dhe programet e studimit për Administratë Publike; dhe
- Katër projekte: Nxitja e punësimit përmes biznesit dhe zhvillimit të aftësive (financuar nga Danida), Asistencë Teknike për zhvillimin e bujqësisë (TAMAD) financuar nga Danida dhe dy projekte të bashkë-financuara nga UN Habitatit⁴.

Sezoni i auditimit 2014/15 ka filluar në shtator të vitit 2014 dhe planifikojmë të raportojmë 118 auditime:

- Raportin e auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e tetë raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK-së;
- Tetëmbëdhjetë auditime të performancës: Sistemi i Prokurimit në Sektorin e Shëndetë-

sisë; Monitorimi i përdorimit të pajisjeve medicinale; Aktivitetet e policisë së trafikut dhe Siguria në Komunikacionin Rrugor; Dizajnimi dhe funksionimi i sistemit menaxhues të RTK-së; Masat e efijencës së energjisë 2010-15; Qasja fizike në objekte për personat me aftësi të kufizuara fizike; Sistemi i trajnimit për nëpunësit civilë; Monitorimi i shitjeve përmes spin-off-it special; Subvencionet bujqësore nga niveli qendror; Subvencionet bujqësore nga nivel lokal; Zbatimi i strategjisë së e-Queverisjes 2009-2015; Kontrata për "Furnizim me material ndërtimor dhe ndërtimin e shtëpive për të kthyerit"; Kontrolli i emitimit të gazrave të automjeteve; Kontrolli i cilësisë së karburantit; Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare; Kontratat për prokurimin e ushqimit; Përcjellja e rekomandimeve në auditimin "menaxhimi i mbeturinave medicinale"; dhe indikatorët e performancës në Komuna për vitin 2014; dhe

- Njëmbëdhjetë Projekte: njëri i financuar nga Danida (TAMAD), nëntë të bashkë-financuara nga UN Habitatit dhe fondi i përbashkët në sektorin e arsimit.

Tabela 1 tregon portfolion tonë të përgjithshme të auditimit, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për tre vitet e fundit. Për sezonin aktual të auditimit, fokusi ynë kryesor ishte në konsolidimin e auditimeve tona të rregullsisë, zhvillimin e auditimeve jo-statutore në aspektin e mbulimit.

Ne presim që të rritet numri i auditimeve të tilla sepse besimi i donatorëve ndërkombëtar në profesionalizmin dhe kredibilitetin e punës sonë të auditimit është rritur dhe duke bërë këtë, trasojmë rrugën për mbështetje direkte buxhetore.

⁴ Ne kemi lidhur një kontratë dy vjeçare me UN Habitat për të mbulimin e 12 auditimeve. Dy nga këto projekte u finalizuan gjatë sezonit të auditimit 2013/2014.

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të kryera gjatë sezoneve

| Llojet e auditimit | Sezoni i auditimit | Sezoni i auditimit | Sezoni i auditimit |
|------------------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| | 2014/2015 | 2013/2014 | 2012/2013 |
| Auditimi statutor | 90 | 89 | 91 |
| - BK | 1 | 1 | 1 |
| - Autoritetet Shtetërore | 24 | 24 | 24 |
| - Komunat | 38 | 38 | 38 |
| - Të kontraktuara | -6 | -11 | -11 |
| - Institucionet e pavarura | 27 | 26 | 26 |
| Jashtë BK-së | 0 | 0 | 2 |
| Auditimi jo-statutor | 29 | 13 | 17 |
| - Auditimet e Performancës | 18 | 9 | 5 |
| - Auditimet Menaxheriale | 0 | 0 | 10 |
| - Auditimet e Sistemit | 0 | 0 | 1 |
| - Auditimi i fondeve të donatorëve | 11 | 4 | 1 |
| Gjithsej | 119 | 102 | 108 |

Në nivel të qeverisjes lokale, ne kemi vazhduar kontraktimin e punës tonë tek firmat private të auditimit në komuna edhe pse numri i auditimeve të kontraktuara është zvogëluar në gjashtë. Kjo na mundëson të krahasojmë cilësinë e auditimeve tona me atë të sektorit privat.

2.2 CILËSIA E RAPORTEVE TONA

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (SMC), i cili përfshin cilësinë si një kërkesë themelore në të gjitha aktivitetet, mbetet njëri ndër prioritetet tona kryesore. Ne sigurojmë se auditimet e përfunduara janë në pajtim të plotë me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik si dhe më praktikat e mira evropiane dhe siguron një cilësi të lartë të raportimit.

SMC përbehet nga tri (3) komponentë kryesore:

- Kontrolli i cilësisë;
- Monitorimi i cilësisë; dhe
- Sigurimi i cilësisë.

Kontrolli i cilësisë është kontrolli që kryhet për secilin auditim përmes rishikimit të tërë procesit të auditimit përfshirë aplikimin efektiv të metodologjisë së auditimit të ZAP e që ka të

bëjë me planifikimin, realizimin dhe dokumentimin e auditimit përfshirë raportimin formal.

Të gjitha auditimet e kryera për pasqyrat financiare të vitit 2014, para se të dorëzoheshin janë monitoruar në vazhdimësi nga menaxhmenti, duke filluar me Udhëheqësin e Ekipit të Auditimit, Drejtorin e Auditimit, Asistent Auditorin e Përgjithshëm e deri te Auditori i Përgjithshëm. Shablloni i modifikuar për raportet e auditimit është aplikuar për auditimet e vitit 2014.

Monitorimi i cilësisë është funksion i rishikimit të brendshëm nga Departamenti i Mbështetjes së Auditimit. Monitorimi i cilësisë edhe gjatë vitit 2014 është mbështetur nga partnerët tanë ndërkombëtar, përmes Projektit të Binjakëzimit të BE-së.

Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar pilot auditime dhe auditime që nuk janë pilote. Ky proces ka mbuluar të gjitha fazat e auditimit, për të siguruar se dëshmitë e duhura dhe të mjaftueshme të auditimit kanë mbështetur raportimin e auditimit dhe opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Sigurimi i cilësisë është një rishikim i pavarur pas auditimit i cili behët përmes një kombinimi të rishikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Rishikime të tilla bëhen në baza periodike, përkatë-

sisht çdo tri ose katër vite. Në rrethanat aktuale ne po përdorim vlerësimet ndërkombëtare si përfaqësim për këtë, shih kapitullin 2.4.

Rezultatet nga mësimet e nxjerra vjetore, de-tyrat dhe reagimet e marra nga partnerët e jashtëm janë përdorur në bërjen e ndryshimeve pozitive në mënyrën se si kryhen auditimet tona dhe si raportohen rezultatet. Ne jemi të përkushtuar për të konsoliduar përmirësime të mëtejshme në auditimet tona statutoare si dhe për të zhvilluar cilësinë e auditimeve jo-statutoare. Partnerët tanë të ndryshëm janë duke na ndihmuar që ti arrijmë këto objektiva të cilësisë.

2.3 NDIKIMI

Ndikimi i auditimit pasqyrohet me veprimet e ndërmarra në nivele të ndryshme për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe performancës së përgjithshme financiare dhe operative. Raportet tona informojnë përdoruesit tjerë, investitorët, donatorët dhe publikun e gjerë dhe në këtë mënyrë rritet transparenca dhe ndërgjegjësimi.

Raportet tona kanë rezultuar në:

- Identifikim më të mirë të arsyeve për sfidat dhe mangësitë në menaxhimin e financave publike;
- Përmirësime në dizajnin e qeverisjes së brendshme, menaxhimit financiar dhe kontrollin;
- Zbatim më të mirë të proceseve të menaxhimit dhe
- Një debat më të informuar publik.

Numri i raporteve të auditimit të adresuara në dëgjimet publike të KMFP-së, ku përfaqësues nga ekzekutivi kanë dhënë llogari për mënyrën se si kanë menaxhuar me burimet publike, ka rënë dukshëm në vitin 2014. Mbikëqyrja parlamentare është aplikuar vetëm për dy autoritete në krahasim me 16 në vitin 2013 dhe 17 në vitin 2012 (kjo gjithashtu përfshinte një seancë të përbashkët për të gjitha komunat). Për shkak të këtij zhvillimi ne kemi përqendruar burime shtesë në përcjelljen e rekomandimeve të auditimit.

Përveç auditimit të rregullsisë, qeverisja e mirë ka qenë një fushë e veçantë e rishikimit gjatë dy viteve të fundit. Kjo fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e menaxhimit të rrezikut brenda organizatave, si dhe masat për parandalimin dhe eliminimin e tyre.

Ne gjithashtu jemi aktiv në takimet e komitetit drejtues të KBFP-së të cilat fokusohen në zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik. Më tej, disa organizata të audituara kanë kërkuar ndihmë dhe këshilla tek ne, kur u përballën me vështirësi të caktuara procedurale në operacionet e tyre financiare.

Në këtë mënyrë ne kemi identifikuar mundësitë për përdorim më të mirë të burimeve publike, përmirësim të kost-efektivitetit të ofrimit të shërbimit, llogaridhënies dhe transparencës të rritur. Ne kemi theksuar çështjet të cilat kanë rezultuar në përdorim joefikas, shpërdorim dhe/ose menaxhim jo të duhur të burimeve publike dhe veprimet e rekomanduara të cilat ofrojnë potencial të rëndësishëm për përmirësime.

Opinionet e auditimit

Organizatat buxhetore janë duke përmirësuar proceset e tyre të cilat mbështesin përgatitjen e Pasqyrave të tyre Vjetore Financiare në masë të madhe si rezultat i këshillave dhe rekomandimeve tona të auditimit. Opinionet e auditimit të dhëna për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2013 pasqyrojnë një pjesëmarrje në rritje të opinionëve të pamodifikuara⁵ edhe pse numri i theksimeve të çështjes është në rritje, kryesisht për shkak të regjistrimit jo të plotë të pasurisë.

Pas sfidave të identifikuar me raportim të pasurisë, është krijuar një komision i veçantë ndërqeveritar me qëllim të zgjidhjes së problemeve me sistemin e regjistrimit të pasurive. Ne kemi marrë pjesë si vëzhgues.

⁵ Termi "Opinion i pamodifikuar" është ekuivalent me termin "Opinion i pakualifikuar" që është përdorur në raportet tona të viteve të mëparshme. Formulimi i ri është në përputhje me standardet e auditimit të INTOSAI (ISSAI 200).

Tabela 2: Opinonet e Auditimit të dhëna gjatë tre viteve të fundit

| Lloji i Opinionit | 2013 | 2012 | 2011 |
|---|-----------------------|-----------------------|-----------|
| Opinion i Pamodifikuar | 37 | 38 | 35 |
| Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes | 47 | 42 | 32 |
| Opinion i Modifikuar | 2 | 2 | 15 |
| Opinion i Modifikuar me Theksim të Çështjes | 0 | 6 | 4 |
| Opinion i kundërt | 4 | 0 | 0 |
| Mohim i opinionit | 2 | 3 | 3 |
| Gjithsej | 92⁶ | 91⁷ | 89 |

Numri dhe përqindja e rekomandimeve të adresuara

Në secilin nga raportet tona të auditimit ne japim rekomandime për udhëheqësit e organizatave të audituara. Kjo i ndihmon ata që të përmirësojnë qeverisjen, transparencën dhe llogaridhënien. Në këtë mënyrë ne japim kon-

tributin tonë në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe shfrytëzimin më të mirë të burimeve në dispozicion.

Përcjellja e implementimit të rekomandimeve tona të vitit të kaluar është pjesë përbërëse e auditimit tonë. Rezultatet nga këto analiza janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3: Zbatimi i rekomandimeve të mëhershme

| Grupet e Institucioneve të audituara | Rekomandimet | | plotësisht të adresuara | | Pjesërisht të adresuara (në proces) | | Të pa adresuara | |
|--------------------------------------|--------------|------------|-------------------------|---|-------------------------------------|-----------|-----------------|-----------|
| | nr. | nr. | nr. | % | nr. | % | nr. | % |
| Institucionet e nivelit Qendror | 354 | 159 | 45 | | 108 | 30 | 87 | 25 |
| Institucionet e pavarura | 221 | 128 | 58 | | 40 | 18 | 53 | 24 |
| Institucionet e nivelit lokal | 425 | 119 | 28 | | 103 | 24 | 203 | 48 |
| Gjithsej | 1000 | 406 | 41 | | 251 | 25 | 343 | 34 |

Krahasuar me vitin paraprak, numri i rekomandimeve të adresuara nga organizatat e nivelit qendror është vazhdimisht në rritje, derisa ekziston një rritje e lehtë në përqindjen e rekomandimeve të adresuarat plotësisht nga komunat. Megjithatë, ne mbetemi të shqetësuar për numrin e rekomandimeve të pa adresuara andaj janë të nevojshme disa masa efektive për të adresuar këtë situatë. Institucionet e pavarura (përveç Universitetit të Prishtinës, Zyrës së Presidentit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit të cilat duhet të marrin masa shtesë) i kanë adresuar rekomandimet tona në mënyrë të kënaqshme.

Janë dhënë këshilla se si duhet adresuar rekomandimet e mëparshme dhe përmirësuar më tej menaxhimin financiar dhe kontrollin. Këshil-

la në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare është zbatuar në një shkallë të madhe që rezulton në një cilësi më të lartë të informacionit financiar në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Progresi i bërë tregon ndikim të përmirësuar të punës sonë. Rekomandimet tona janë më të rëndësishme, më praktike dhe më të kuptueshme.

⁶ Shifra e përgjithshme është më e lartë se institucionet e audituara për shkak se dy opinione janë dhënë për Agjencinë e Privatizimit (agjencinë dhe fondin). Përveç kësaj kjo shifër përfshin opinione për dy projekte të financuara nga donatorët (financuara nga Danida).

⁷ Numri i përgjithshëm i opinioneve përfshin opinionin për fondin e Privatizimit. Përveç kësaj, kjo shifër përfshin opinionin për një projekt të financuar nga donatorët (financuar nga Danida) dhe opinionin për "Trepçën".

2.4 VLERËSIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM

Gjatë vitit janë kryer disa vlerësime të jashtme. Një kompani konsulente ka vlerësuar bashkëpunimin mes nesh dhe Zyrës Kombëtare Suedeze të Auditimit. Vlerësimi ishte i gjerë dhe ka dhënë kontribut interesant për qasjet tona të ardhshme të zhvillimit dhe prioritetet si dhe konfirmim për rezultatet e arritura. Raporti është dorëzuar në dhjetor, ndërsa disa nga konkluzionet ishin se:

“ZAP ka përmirësuar performancën e vet në kuptim të afateve kohore të dorëzimit të raporteve të auditimit, mbulimit të mandatit të tij të auditimit dhe numrit të entiteteve të audituar çdo vit... besueshmëria dhe saktësia e pasqyrave financiare në qeveri dhe raportet e auditimit të ZAP tani vlerësohen mjaft shumë... ZAP konsiderohet si një institucion i pavarur dhe i besueshëm.

... Mbështetja e ZKSA ka qenë mjaft e kufizuar dhe pjesa më e madhe e suksesit të ZAP nuk mund t'i atribuohet kësaj mbështetje... ekziston një konsensus se mbështetja (e dhënë) ka qenë e dobishme dhe duhet të vazhdojë...

... Arritjet kryesore janë se programi i certifikimit për auditor financiar/rregullsisë është zbatuar, disa raporte të auditimit të performancës të cilësisë së ishin ose janë duke u prodhuar, dhe në përdorim është sistemi i raportimit të kohës si dhe përgatiten raporte të BNJ-ve.

Ka ende punë për të bërë për të përmirësuar përmbajtjen e certifikimit dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional në auditimin e rregullsisë, si dhe për të zhvilluar aftësitë për menaxhim të projektit si dhe rolin e menaxhmentit të mesëm, për të hartuar një progresion apo certifikim edhe për auditorët e performancës, për të përmirësuar më tej produktivitetin dhe cilësinë e auditimit të performancës, për të integruar raportimin e kohës në sistemet tjera, si dhe për të përmirësuar marrëdhëniet e sindikatës...

...Ekzistojnë disa faktorë të rëndësishëm që do të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të ZAP-it; Së

pari, sfida të reja që ndodhin për shkak të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në në fushën e MF/K-së, raportimit të jashtëm dhe të integruar, statistikave, mbrojtjes së interesave financiare të BE-së dhe një futje e mundshme në funksion të mbështetjes direkte buxhetore. Së dyti, emërimi i mundshëm i një AP tjetër, përfundimi i projektit të binjakëzimit të BE-së dhe rishikimi i pritur i legjislacionit të auditimit”.

Në emër të Bashkimit Evropian është bërë rishikimi i Monitorimit të orientuar kah rezultatet (MOR) për projektin e Binjakëzimit. Konkluzioni ishte se:

“Ndërtimi i kapaciteteve institucionale kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e efektivitetit në procesin e auditimit. Progresi është aq i mirë sa që nevoja për një binjakëzim përcjellës më të lehtë duhet të rivlerësohet në fazën e fundit të projektit (ose madje edhe më vonë). I vetmi rrezik i mundshëm për pavarësinë e plotë të ZAP-it është miratimi në pritje i Ligjit për Themelimin e funksionit të auditimit, por kjo është një çështje politike përtej fushëveprimit të këtij Binjakëzimi”.

Për më tepër, rishikimi ka rekomanduar që:

“Zyra e BE-së dhe ZAP: të ri-vlerësohet nevoja për një mbështetje eventuale të shkurtër të binjakëzimit në fazat e fundit gjegjësisht në fund të dimrit/pranverës të vitit 2015, kur do të jetë më e qartë nëse nevojitet ndihma shtesë apo jo;

ZAP, Zyra e BE-së dhe Menaxhmenti i Binjakëzimit: Dokument Strategjia IPA II për Kosovën duhet të përfshijë kushte, të cilat do të ndërtohen mbi shtyllat kryesore të SZHK. Në këtë mënyrë, SZHQ do të sigurojë bazën për zhvillimin afatmesëm dhe lidhjet me zhvillimin e vet sektorit të Reformës së Administratës Publike (RAP).”

Në aspektin e brendshëm, si çdo vit, ne kemi mbajtur konferencën tonë vjetore verore. Rendi i ditës përfshinte mësimet e nxjerra nga diskutimet për zbatimin e strategjisë dalëse dhe mësimet e nxjerra gjatë sezonit të auditimit 2013/14. Konferenca është forum për ndërveprim dhe ofron një platformë për të gjithë stafin

që të paraqesin pikëpamjet e tyre, shkëmbejnë njohuri, ide dhe përvoja si dhe të gjejnë zgjidhje për sfidat ekzistuese. Pjesë e konferencës janë edhe diskutimet me palët më të afërta të interesit rreth mundësive të reja për bashkëpunim dhe ndërveprim.

Përveç kësaj, më shumë për vlerësimet e brendshme mund të gjeni tek pjesa 2.2 Cilësia e raporteve tona.

2.5 REKOMANDIMET NGA AUDITORËT TANË TË JASHTËM

Kuvendi ka emëruar një firmë private të auditimit për auditimin e pasqyrave tona vjetore financiare për vitin 2014. Auditorët kanë dhënë opinion të pa-modifikuar, që do të thotë se pasqyrat tona në të gjitha aspektet janë prezantuar drejtë (shih Shtojcën III).

Në Letër rekomandimi për Menaxhmentin, auditorët kanë deklaruar se nuk kanë vërejtur çështje që përfshinë kontrollin e brendshëm dhe operacionet që konsiderohen të kenë mangësi materiale. Auditorët gjithsesi kanë vërejtur çështje të tjera në lidhje me strukturën e kontrollit të brendshëm dhe disa çështje tjera të kontabilitetit ose çështje operative, të cilat janë prezantuar në letër rekomandimi për menaxhmentin që është dorëzuar tek ne e po ashtu edhe në Kuvend.

03.

BURIMET

Burimi kryesor i financimit të ZAP-it është BK. Pagat e Auditorit të Përgjithshëm dhe ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm deri në fund të gushtit janë bashkë-financuar nga Qeveria Suedeze dhe BK dhe administruar nga Grupi i Menaxhues Ndërkombëtar (GMN). Nga 1 shtatori i vitit 2014, postin e ka ushtruar ushtruesi i detyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm ishte angazhuar me kontratë për shërbime.

Donacionet janë pranuar edhe nga partnerët ndërkombëtarë për të mbështetur zhvillimin tonë të mëtejshëm. Të hyrat e kufizuara janë krijuar edhe nga auditimi i projekteve të financuara nga donatorët.

3.1 BURIMET FINANCIARE

Buxheti fillestar prej 2,130,753€ për vitin 2014 ishte nënshtruar ndryshimeve të mëposhtme:

- Pagat dhe Mëditjet: Qeveria e Kosovës ka rritur pagat për të gjithë shërbyesit civil për 25% që nga prilli i vitit 2014. Si rezultat, buxheti final ishte 1,480,232€ në krahasim me shumën e aprovuar prej 1,349,253€. Diferenca prej 130,979€ është financuar nga

alokimet e reduktuara të mallrave dhe shërbimeve si dhe Shërbimeve komunale prej 15% dhe 18,254€ janë alokuar nga Ministria e Financave - kontigjenca për paga;

- Mallrat dhe Shërbimet dhe Shërbimet Komunale: Bazuar në vendimin e Qeverisë nr.07/172 të datës 27.02.2014 për kursimin e shpenzimeve nga organizatat buxhetore, 15% e buxhetit prej 751,500€⁸ nuk janë alokuar. Kjo shumë prej 112,725€ është transferua nga Qeveria në kategorinë e pagave dhe mëditjeve; dhe
- Donacionet nga partnerët tanë prej 61,172€ janë transferuar në mallra dhe shërbime.

Donacionet:

- a) Bashkimi Evropian/Projekti i Binjakëzimit – ka dhënë donacion prej 10,000€ për të bashkë-financuar konferencën tonë të gjashtë vjetore të mbajtur në korrik në Tiranë, Shqipëri.
- b) Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit - ka dhënë donacion prej 7,838€ për të bashkë-financuar

⁸ Baza ishte buxheti prej 711,500€ në buxhetin për Mallra dhe Shërbime dhe 40,000€ në buxhetin për Shërbime Komunale.

konferencën tonë të gjashtë vjetore të mbajtur në korrik në Tiranë, Shqipëri si dhe për marrjen me qira të hapësirave për punë për nevojat e stafit tonë gjatë një punëtorie në Prishtinë.

- c) Banka Botërore - është duke na mbështetur përmes një projekti 20 muajsh i fokusuar në auditimin e sistemeve të prokurimit publik. Shuma prej 43,334€⁹ është transferuar në buxhetin tonë, 39,029€ janë shpenzuar dhe diferenca është transferuar në buxhetin e ZAP për vitin 2015.

Të hyrat tjera:

Shuma prej 5,220€ përfaqëson vlerën e të hyrave të gjeneruara nga auditimet e projekteve të donatorëve të financuara nga DANIDA, TAMAD dhe UN Habitat. Këto të hyra janë depozituar direkt në Buxhetin e Kosovës dhe nuk janë përdorur nga ne.

Pas ndryshimeve të përmendura më lart, buxheti ynë përfundimtar në fund të vitit 2014 ishte 2,210,179€.

Tabela 4: Buxheti i ZAP (në EUR `000)

| Raporti i buxhetit | Buxheti fillestar | Buxheti final | Buxheti i shpenzuar | Përqindja % |
|-------------------------------|-------------------|---------------|---------------------|-------------|
| 2014 | | | | |
| Buxheti i përgjithshëm | 2,131 | 2,210 | 2,169 | 98% |
| Pagat dhe Mëditjet | 1,349 | 1,480 | 1,480 | 100% |
| Mallrat dhe Shërbimet | 712 | 666 | 644 | 97% |
| Shërbimet komunale | 40 | 34 | 27 | 80% |
| Transfere dhe subvencione | - | - | - | - |
| Investimet Kapitale | 30 | 30 | 18 | 59% |
| 2013 | | | | |
| Buxheti i përgjithshëm | 2,120 | 2,121 | 2,006 | 95% |
| Pagat dhe Mëditjet | 1,305 | 1,285 | 1,268 | 99% |
| Mallrat dhe Shërbimet | 620 | 666 | 614 | 92% |
| Shërbimet komunale | 45 | 45 | 29 | 64% |
| Transfere dhe subvencione | 100 | 75 | 75 | 100% |
| Investimet Kapitale | 50 | 50 | 20 | 41% |
| 2012 | | | | |
| Buxheti i përgjithshëm | 2,010 | 1,937 | 1,822 | 94% |
| Pagat dhe Mëditjet | 1,198 | 1,215 | 1,174 | 97% |
| Mallrat dhe Shërbimet | 622 | 622 | 561 | 90% |
| Shërbimet komunale | 40 | 40 | 32 | 80% |
| Transfere dhe subvencione | 100 | | | 0% |
| Investimet Kapitale | 50 | 60 | 55 | 92% |


Buxheti ynë i aprovuar për vitin 2014 është për 4.2% më i lartë krahasuar me vitin 2013, derisa buxheti i 2013 ishte për 9.5% më i lartë se sa i vitit 2012. Këto rritje reflektojnë kosto më të larta për stafin.

Nën-shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale për vitin 2014 reflektojnë një mangësi në finalizimin e procesit të prokurimit për pajisjet e zyrës dhe përdorim më


të ulët të energjisë elektrike dhe telefonisë fikse. Nën-shpenzimet në Investimet Kapitale pasqyrojnë faktin se moduli i rekrutimit elektronik (Loti 2 i Sistemit të MBNJ-së) nuk ka mundur të përfundojë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të operatorëve të përgjegjshëm ekonomik.

⁹ Kjo shumë është dhënë nga Banka Botërore, por fillimisht është paguar nga BK. Mbetet që Fondet mbeten të rimbursohen Qeverisë.

Grafiku 1. Shpenzimet buxhetore nëpër kategoritë ekonomike



Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në kategorinë Mallra dhe Shërbime



Grafiku 2 paraqet shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ku:

- Elementi më i lartë (30%) mbetet marrja me qira e zyrës së ZAP;
- 15% ka të bëjë me trajnimin profesional të auditorëve të sektorit publik¹⁰;
- 14% ka të bëjë pagesat për kontraktimin e auditimeve të komunës dhe pagesat e financuara nga Banka Botërore lidhur me auditimin e prokurimit; dhe
- 11% e shpenzimeve kanë të bëjnë me punën e ekipeve në terren (të udhëtimit dhe mëditjet), shpenzimet e pjesëmarrjes së stafit në seminare jashtë vendit (punëtori në Shqipëri, Suedi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kongresi i EU-ROSAI-it, kongresi i FNK-së, Rrjeti i ISA-ve për vendet candidate), kandidatin dhe potencial-

isht candidate si dhe shpenzimet që lidhen me auditimin e Ambasadave të Kosovës në Bruksel, Francë, Suedi, dhe Gjermani.

3.2 PASURITË

Për shkak të situatës me buxhet të pakët, zhvlerësimit dhe politikës sonë për shpenzim të kujdesshëm, vlera e pasurive tona është në rënie e sipër çdo vit. Mundësia për investime të reja kapitale për të përmbushur kërkesat e reja teknologjike ka qenë e kufizuar.

¹⁰ Në korrik 2013 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi mes ZAP-it dhe SHKÇAK për Skemën e certifikimit të Sektorit Publik

Mjete të reja të TI-së dhe zgjidhjet që kontribuojnë në auditim më efikas dhe mbështetje të auditim është dashur të ri-profilizohen për vitet e ardhshme buxhetore.

Vlera e pasurisë kapitale ishte 115,000€ në fund të vitit 2012, 84,000€ në fund të vitit 2013 dhe 69,000€ në fund të vitit 2014. Vlera e pasurive tona jo-kapitale ishte 115,000€, respektivisht 101,000€ dhe 97,000€.

Sistemi e-pasuria nuk është plotësisht funksional e që shpie në probleme sa i përket llogaritjes së zhvlerësimit dhe ende bëhet ri-vlerësimi tashmë i pasurive plotësisht të zhvlerësuara.

Të gjitha automjetet tona që janë ende në përdorim kanë pasur vlerë neto zero që nga viti 2013. Pasuritë e reja të blera gjatë vitit 2014 kryesisht ndërlidhen me përditësim të TIK-ut, softuer dhe harduer.

3.3 BURIMET NJERËZORE

Qëllimi ynë është të punësojmë një fuqi punëtore të talentuar dhe të ndryshme që reflekton njerëzit të cilëve u shërbejmë. Politikat tona të rekrutimit janë të dizajnuara për të nxitur aplikime nga një gamë sa më e gjerë e dhe komuniteteve.

Në vitin 2014, kemi pasur gjithsej 147 të punësuar. Struktura e personelit përbëhet nga grupi i

menaxhmentit, auditorët dhe stafi mbështetës. Përveç kësaj, ne gjithashtu punësuam katër zëvendësues për të zëvendësuar stafin në mungesë.

Mandati i Auditorit të Përgjithshëm ka përfunduar në gusht të vitit 2014. Zëvendës Auditori i Përgjithshëm është aktualisht duke shërbyer si ushtrues detyre i Auditorit të Përgjithshëm. Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm vazhdon të jetë i angazhuar sipas një marrëveshje për Shërbime të veçanta pas përfundimit të projektit të Auditorit të Përgjithshëm me GMN-në.

Në vitin 2014, ne kemi rritur numrin e stafit me BK për tre. 81.6% janë auditorë dhe 18.4% janë staf mbështetës, nga të cilët 72 femra dhe 75 meshkuj. Mosha mesatare e punonjësve është 38.1.

94% e stafit tonë ka shkallë të ndryshme universitare në fusha relevante, ndërsa pjesa tjetër kanë përfunduar arsimin e mesëm.

Nevojat e stafit tonë janë në rritje për shkak të kërkesave të partnerëve tanë dhe palëve të interesit për të kryer më shumë auditime. Ndryshimet në kornizën tonë ligjore mund të rrisin këtë kërkesë.

Statistikat në lidhje me stafin gjatë viteve të fundit mund të gjenden në tabelat e mëposhtme ku theksohet rritja e numrit të stafit femëror, tani përbëjnë pothuajse 50% dhe me lëvizje të ulët të stafit.

Tabela 5: Stafi gjatë viteve

| Viti | Kufiri i stafit | Numri i komuniteteve | Përqindja e femrave | Numri i drejtorëve (femra) | Mosha mesatare | Numri i udhëheqësve të ekipit | % Lëvizja e personelit | Përvoja në zyrë më e gjatë se dy vite |
|------|-----------------|----------------------|---------------------|----------------------------|----------------|-------------------------------|------------------------|---------------------------------------|
| 2012 | 136 | 6 | 45.8% | 5 | 36.7 | 29 | 0.7 | 108 |
| 2013 | 140 | 6 | 47.9% | 6 | 37.1 | 38 | 3.75% ¹¹ | 127 |
| 2014 | 146 | 6 | 48.9% | 7 | 38.1 | 43 | 1.36 ¹² | 137 |

¹¹ Dy kanë dhënë dorëheqje dhe një ka vdekur.

¹² Një ka dhënë dorëheqje dhe njërit është ndërprerë kontrata.

Tabela 6: Kategoritë e stafit (postet e mbajtura në fund të vitit)

| Kategoria | 2014 | | 2013 | | 2012 | |
|---------------------|-------------------------|------------|-----------------|------------|-----------------|------------|
| | Shifrat aktuale | Pozitat | Shifrat aktuale | Pozitat | Shifrat aktuale | Pozitat |
| Stafi auditor | 120 | | 121 | | 114 | |
| Stafi Administrativ | 27 | | 27 | | 28 | |
| Gjithsej | 147¹³ | 146 | 148 | 140 | 142 | 136 |

Proceset e rekrutimit

Proceset tona të rekrutimit bazohen në vlera dhe parime të kornizës ligjore për shërbimin civil në Kosovë, standardet e pranuar ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik (SNISA) dhe praktikatat e mira evropiane. Në vitin 2014 kemi përfunduar katër procese të rekrutimit: dy auditorë, një përkthyes të gjuhës shqipe, serbe, dhe një zëvendësues për Asistente në BNJ. Ne kemi vazhduar me sjelljen e përkthyesve të përkohshëm gjatë pikut të sezonit.

Trajnimi dhe zhvillimi

Pasi jemi një institucion i bazuar në njohuri që punon sipas standardeve të cilat vazhdimisht evoluojnë, vëmendje e madhe i kushtohet programeve tona të trajnimit dhe zhvillimit.

Ne kemi ofruar një numër trajnimesh të brendshme dhe kemi marrë pjesë në disa të jashtme. Ne kemi prezantuar edhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZHVP) si pjesë e

Programit për Certifikim Publik të bërë në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK).

Në fund, ne kemi organizuar mbi 12,000 orë trajnimi jashtë dhe brenda zyrës gjatë vitit 2014.

- Kemi organizuar 13 trajnime specifike për stafin tonë, me rreth 3,000 orë trajnimi, të ofruara kryesisht nga partnerët tanë bashkëpunues nga Mbretëria e Bashkuar, Holanda dhe Suedia;
- Dy anëtarë të stafit tonë kanë marrë pjesë në trajnime për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik organizuar nga CIPFA¹⁴;
- Pesë anëtarë të stafit kanë vijuar trajnimet e ofruara nga IKAP-i; dhe
- Ka vazhduar skema e re e certifikimit publik. Janë organizuar gjithsej shtatë module të trajnimit, që numëron gjithsej 9100 orë trajnimi.

Situata aktuale për sa i përket pjesëmarrjes mund të shihet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Numri i pjesëmarrësve në module të ndryshme të certifikimit publik

| Skema e certifikimit për Sektorin Publik - Modulet e trajnimit | | |
|--|-----------------------|----------------|
| Moduli | Numri i pjesëmarrësve | Periudha |
| M1. Raportimi Financiar | 5 | maj-qershor |
| M2. Planifikimi dhe Buxheti | 47 | shkurt-mars |
| M3. Ligjet kombëtare (moduli ligjor) | N/A | N/A |
| M4. Procedurat dhe Teknikat e Menaxhimit të Financave Publike | 46 | shkurt-prill |
| M5. Qeveria, Rreziku dhe Kontrolli | 29 | janar |
| M6. Metodologjia e auditimit I | 36 | qershor-korrik |
| M7. Metodologjia e auditimit II | 52 | shtator-tetor |
| M8. Menaxhimi Financiar | 35 | prill-maj |
| Gjithsej | 204 | |

¹³ Numri i pozitave në fund të vitit ishte 147. Numri është më i lartë se pozitat e miratuara për shkak të rekrutimit të zëvendësuesve të cilët zëvendësojnë stafin në mungesë

¹⁴ Chartered Institute of Public Finance and Accountancy (Instituti i licencuar i Financave Publike dhe Përgjegjësive)

242 provime, ose 67.6%, kanë kaluar me sukses.

Politika për përcaktimin e kriterëve për gradimin e stafit në bazë të skemës së re të certifikimit publik është në përgatitje e sipër. Kjo politikë do të marrë në konsideratë rezultatet

e provimit, së bashku me performancën dhe përvojën.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e stafit tonë në nivele të ndryshme të skemës së certifikimit privat dhe titujt aktual të tyre:

Tabela 6: Kategoritë e stafit (postet e mbajtura në fund të vitit)

| Kategoria | 2014 | 2013 | 2012 |
|---------------------------|------------|------------|------------|
| Auditor i certifikuar | 27 | 28 | 25 |
| Kontabilist i certifikuar | 31 | 31 | 29 |
| Teknik i Kontabilitetit | 28 | 24 | 28 |
| Auditor në trajnim | 20 | 23 | 14 |
| Auditor i Performancës | 12 | 11 | 8 |
| Auditor i Brendshëm | 1 | 1 | 1 |
| Gjithsej | 119 | 119 | 106 |

Stafi ynë i komunitetit serb vazhdon të marrë pjesë në një skemë të certifikimit ofruar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Serbisë.

Ne kemi ofruar edhe punë praktike për dy studentë të fakultetit juridik në bazë të një marrëveshjeje me Universitetin e Prishtinës.

Zhvillimi i Mjeteve Ndhmëse

Si pjesë e drejtimit tonë strategjik ne kemi iniciuar zhvillimin e mjeteve të BNJ-së për menaxhimin e informacionit të stafit dhe regjistrimin e kohës që na mundësojnë të jemi më efikas në trajtimin e çështjeve të BNJ-së. Sistemi i Informacionit të Burimeve Njerëzore dhe Sistemi i Regjistrimit të Kohës janë zhvilluar dhe instaluar, dhe janë në fazën e rishikimit.

Ne nuk ishim në gjendje të finalizojmë prokurimin e sistemit E-Rekrutimi për shkak të numrit të pamjaftueshëm të ofertave përgjegjshme. Por, kjo ende mbetet një nga hapat tonë të ardhshëm që duhet ndërmarrë.

Sindikata

Pjesë integrale e ambicies sonë strategjike në zhvillim të një Institucioni Suprem të Auditimit i cili performon mirë është zhvillimi i një Sindikate të pjekur. Pikëpamja jonë është se një sin-

dikatë duhet të veprojë në interesin afatgjatë dhe afatshkurtër të anëtarëve të saj dhe në të njëjtën kohë të kontribuojë në proceset e ndryshimit të nevojshme për arritjen e ambicies strategjike të ZAP-it.

Në vitin 2014 ne kemi nënshkruar një marrëveshje për komunikim formal me Sindikatën e Punëtorëve të Zyrës tonë (SHSPZAP). Kjo marrëveshje ka shërbyer për të qartësuar rolin përkatës dhe përgjegjësinë e menaxhmentit dhe përfaqësuesve të sindikatës dhe për të formuar një bazë për të punuar së bashku në partneritet.

Stafi, i cili i përket sindikatës paguan vet tarifën e tyre të anëtarësimit të cilat ose zbriten nga pagat e tyre apo paguhen direkt sindikatës. Ne sigurojmë objektin për zyrë përfaqësuesve të sindikatës tonë dhe gjithashtu kemi caktuar një hapësirë në faqen e SharePoint/Intranet, ku SHSPZAP informon anëtarët për aktivitetet sindikale. Ne gjithashtu mundësojmë kohë të caktuar për stafin e zgjedhur të Kryesisë që të merren në veprimtari sindikale. Në fund të vitit 2014, SHSPZAP kishte 87 anëtarë.

Dialogu me Sindikatën aktualisht është ndërprerë për shkak të qasjes dhe veprimeve të ndërmarra nga Sindikata, duke minuar dialogun në mes të dy palëve.

04.

BASHKËPUNIMI

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë është një mekanizëm kyç për të siguruar rezultate pozitive dhe promovuar ndryshime për të siguruar zhvillim efektiv institucional të ZAP-it. Kjo ka pasur ndikim përmes përmirësimit të cilësisë, shkëmbimit të përvojave dhe përfitimeve të ndërsjella për palët në fushën e zhvillimit profesional dhe menaxhimit të shëndoshë të fondeve publike.

Kuvendi, në veçanti Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), është partneri kryesor ynë lokal bashkëpunues. Qëllimi ynë i ndërsjellë është që të kemi ndikim në rritjen e vlerës që arrihet nga paraja publike dhe nga transparenca më e madhe në administratën shtetërore. Komisioni duhet të rishikojë raportet tona të auditimit, të bëjë konkluzione dhe të kërkoj llogaridhënie nga Udhëheqësit e institucioneve. Siç është shpjeguar në kapitullin 2 të këtij raporti, këto aktivitete janë ulur ndjeshëm gjatë vitit 2014 për shkak të ngërçit politik pas zgjedhjeve të përgjithshme. KMFP në përbërje të re ka iniciuar një qëndrim të fortë në mbikëqyrjen parlamentare.

Bashkëpunimi me Qeverinë, në veçanti me Ministrinë e Financave (MF), ka qenë i vazhdueshëm, kur kemi të bëjmë me dhënien e këshillave në procesin e Menaxhimit të Financave Publike. Në vitin 2014 ka filluar një aktivitet bashkëpunimi

me MF-së, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Asociacionit të Komunave, disa projekteve zhvillimore dhe ZAP për zhvillimin e informacioneve si pikë reference për rezultatet dhe financat në komuna. Ne gjithashtu kemi iniciuar bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë për auditimin e brendshëm dhe hartimin e sistemit të prokurimit. Një numër i ministrive janë duke kërkuar këshilla tona sa i përket çështjeve të zhvillimit dhe llogaridhënies.

Ne kemi zhvilluar bashkëpunimin tonë me sektorin e Drejtësisë duke i mbështetur ata në punën e tyre për të siguruar përdorim të duhur të parave publike. Mbështetja jonë për zhvillimin e hetuesve financiar përmes trajnimit dhe përgatitjes së manualit është e një rëndësie të veçantë.

Forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i organizatës janë gjithmonë të nevojshme. Bashkëpunimi ynë me mediat dhe shoqërinë civile luan një rol kyç në këtë. Ne kemi organizuar dëgjime publike me përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile për të diskutuar pritjet e tyre në raport me neve. Iniciativat të cilat i kemi filluar në vitin 2014 duke përfshirë mediat, OJQ-të, akademitë dhe projektet zhvillimore për diskutimin e strategjive dhe zhvillimin e mëtejshëm të nevojave të auditimit.

4.1 PROJEKTET

Partnerët tanë ndërkombëtarë vazhduan të na ndihmojnë në vitin 2014 përmes projekteve të ndryshme.


Projekti i binjakëzimit udhëhequr nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar ka vazhduar të ofrojë asistencë në zbatimin e Strategjisë sonë të Zhvillimit Korporativ. Fokusi ishte në mekanizmat për rritjen e cilësisë në auditimet e rregullsisë me theks të veçantë në pilot auditime, mbështetje për Departamentin për Mbështetje të Auditimit dhe zbatimin e një Metodologjie të përmirësuar. Ka mbështetur edhe fillimin e auditimit të TI-së, elementet e auditimit të performancës dhe përgatitjet për zbatimin e ligjit të ri për themelimin e Zyrës

Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Ky projekt përfundon në mes të vitit 2015.

Bashkëpunimi me ZKA-në suedeze, fokusuar drejt zhvillimit të auditimit të performancës është në vazhdim e sipër dhe drejt thellimit. Ky projekt përfundon në mes të vitit 2016.

Projekti i financuar nga Banka Botërore, pavarësisht disa vonesave, ka vazhduar të na mbështes në zhvillimin e metodave dhe qasjeve tona në auditimin e vlerës për para në sistemet e prokurimit. Ky projekt do të përfundojë në mes të vitit 2015.

Përgatitjet për një Binjakëzim më të lehtë të fokusuar në cilësi dhe qëndrueshmëri të auditimit kanë filluar në fund të vitit 2014. Një projekt i tillë pritet të fillojë në shtator të vitit 2015.





4.2 RRJETI

Në vitin 2014 ne ishim të ftuar dhe kemi marrë pjesë në takime të ndryshme ndërkombëtare. Kjo na ka shërbyer për të promovuar arritjet e ZAP në veçanti dhe Kosovës në përgjithësi, përveç dhënies së kontributit të rëndësishëm për zhvillimin tonë të mëtejshëm.

Auditori i Përgjithshëm dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm kanë marrë pjesë në Kongresin e IX të EUROSAI të mbajtur në Holandë.

Auditori i Përgjithshëm dhe Asistent Auditori i Përgjithshëm kanë marrë pjesë në Kongresin Botëror të Kontabilistëve në Romë dhe ngjarjen e 2-të të Bankës Botërore – Zhvillimi i kontabilitetit për Rezultate

Ne kemi vazhduar me punën tonë në kuadër të Rrjetit ndërmjet presidentëve të ISA-ve në vendet kandidate dhe potencialisht kandidate dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe ishim vëzhgues në takimin e zyrtarëve ndërlidhës të rrjetin e ISA-ve të BE-së në Kopenhagë. Ne jemi të angazhuar në auditimet e performancës paralelisht me vendet e rajonit të mbështetur nga ECA dhe ISA-të nga Evropa Perëndimore. Janë mbajtur katër punëtori dhe parashihet projekti i dytë paralel i auditimit me vendet e rajonit.

Në Stokholm është mbajtur mbledhja e Komitetit Drejtues në kuadër të bashkëpunimit tonë bilateral me Zyrën Kombëtare Suedeze të Auditimit. Kjo gjithashtu përfshinte prezantime dhe diskutime me stafin.

Për të ndërtuar dhe mbajtur rrjetet ne jemi duke shfrytëzuar që disa prej anëtarëve të stafit tonë të bëjnë praktikë në organizatat simotra.

Ne kemi një bashkëpunim të ngushtë me Institucionin Suprem të Auditimit të Shqipërisë për zhvillim profesional dhe shkëmbimin të përvojave dhe ekspertizës në çështjet relevante.

05.

FOKUSI I ARDHSHËM

Institucioni ynë është mjaft i konsoliduar dhe aktualisht i suksesshëm në përmbushjen e objektivave të veta operative. Megjithatë, sfidat aktuale pasqyrohen veçanërisht kur është fjala për menaxhimin strategjik. Mandati pesëvjeçar i Auditorit të Përgjithshëm përfundoi në fund të gushtit të vitit 2014 dhe përgjegjësitë e tij ushtrohen që nga atëherë nga Ushtruesi i Detyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Auditori i Përgjithshëm i ardhshëm do të ketë ndikim të madh në prioritetet e ardhshme dhe menaxhim brenda zyrës. Pasiguritë në këtë drejtim konsiderohen si një nga sfidat kryesore në aspektin e zhvillimit strategjik.

Ne tani jemi duke funksionalizuar një platformë të re për të mbështetur Auditorin e Përgjithshëm të ardhshëm, e që përbëhet prej:

- Strategjia e azhurnuar e Zhvillimit Korporativ (SZHK) në linjë me agjendën evropiane, e miratuar;
- Propozim projekti për një Binjakëzim të shkurtër, për tu miratuar nga BE-ja;
- Ligji i ri për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në, miratuar nga Kuvendi;
- Lista e akteve nënligjore, të përgatitura;
- Manuali i ndryshuar i Auditimit të Rregullsisë, i miratuar;
- Draft skema e certifikimit për Auditorët e Per-

formancës (AP), e zhvilluar dhe implementimi ka filluar;

- Manuali i ndryshuar i Auditimit të Performancës, i miratuar;
- Regjistri i rrezikut për ZAP, i azhurnuar;
- Përcjellës i rekomandimeve i cili përmbledh rezultatet nga partnerët tanë; dhe
- Draft plan për sezonin e auditimit 2015/16.

Përveç kësaj ne jemi duke punuar për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për një zyrë.

Kjo do të jetë një detyrë e rëndësishme për Auditorin e Përgjithshëm të ardhshëm të bëjë një plan veprimi për zbatimin e platformës dhe prioritetet e veta. Këtu do të duhet të përcaktohen veprimet, proceset, duke përfshirë treguesit e performancës dhe afatet kohore, si dhe personat apo departamentet përgjegjëse për monitorim.

SZHK është në linjë me agjendën evropiane dhe qëllimi është që të bëhemi një Institucion Suprem i Auditimit mirë funksionues. Themelet e rëndësishme në këtë janë:

- Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmëria institucionale;
- Kontribuimi në forcimin e qeverisjes së mirë;
- Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë së organizatës dhe auditimit.

- a)** Në mënyrë që të sigurojmë pronësinë vendore dhe qëndrueshmërinë institucionale ne do të konsolidojmë atë që është arritur tashmë dhe zgjerojmë portfolion tonë të biznesit. Ne do të:
- Zhvillojmë udhëzime të brendshme për ligjin e ri;
 - Fillojmë me zbatimin e tyre;
 - Zhvillojmë më tej marrëdhëniet afatgjata me partnerët tanë;
 - Sigurojmë menaxhimin e ndryshimeve dhe orientim kah rezultatet në të gjithë veprimtarinë tonë;
 - Propozojmë (fusim në funksion) zgjidhje të reja të auditimit në sektorin publik, ku shihet e nevojshme;
 - Zhvillojmë më tej bashkëpunimin rajonal mes organizatave simotra dhe pjesëmarrjen në rrjetet ndërkombëtare; dhe
 - Zhvillojmë dhe forcojmë kapacitetet e brendshme organizative.
- b)** Në mënyrë që të kontribuojmë në forcimin e qeverisjes së mirë, në fokus do të jenë këto masa:
- Zhvillimi i mëtejshëm i auditimit të rregullsisë në përputhje me standardet njohura ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik;
 - Ndërmarrja e më shumë auditimeve të performancës me rëndësi të madhe;
 - Vendosja e fokusit më të madh në fushat me interes për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të IPA-s dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE-së;
 - Ndërmarrja e më shumë auditimeve të fondeve të donatorëve;
- Zhvillimi i mëtejshëm i auditimeve të TIK-ut dhe të sistemeve të prokurimit;
 - Vazhdimi i përgatitjes së RVA-së dhe raporteve individuale të auditimit me kohë, me cilësi të rritur dhe rekomandime më efektive të bazuar në relevancë duke siguruar më shumë qasshmëri;
 - Hartimi i Raportit tonë Vjetor të Performancës me kohë dhe me cilësisë më të madhe;
 - Kontribuimi në zhvillimin e treguesve të performancës dhe kostos, raporte referuese dhe kontabiliteti aktual;
 - Promovimi i ekonomisë dhe efikasitetit në dizajnimin e administratës publike;
 - Promovimi i maturisë dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike;
 - Zhvillimi mbështetjes së mëtejshme për funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, konkretisht KMFP-në, për të forcuar përgjegjëshmërinë e personave të ngarkuar me qeverisje;
 - Zhvillimi i bashkëpunimit tonë me Ekzekutivin në fushat e aplikueshme të MSA-së dhe reformimin e administratës publike; dhe
 - Shtrirja e bashkëpunimit dhe komunikimit të jashtëm me shoqërinë civile, mediat dhe projektet zhvillimore.
- c)** Me qëllim të zhvillimit dhe mbajtjes së cilësisë së përgjithshme ne kemi planifikuar të kryejmë veprimet e mëposhtme:
- të rrisim edhe më tej funksionin e cilësisë;
 - të zbatojmë plotësisht programin e ri të certifikimit;
 - të fusim më shumë efikasitet në auditim përmes zgjidhjeve të reja të TI-së; dhe
 - të fusim në funksion mjete më të mira menaxhuese dhe administrative.



06.

LLOGARIDHËNIA E ZAP

Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, garantoj se informacioni në Raportin Vjetor të Performancës, përfshirë edhe pasqyrat financiare, janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.



Artan Venhari, Ushtrues Detyre i Auditorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm

Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, garantojmë se puna jonë gjatë vitit 2014 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Publik dhe Kodin e mirësjelljes së ZAP-it



Ilire Daija-Buza, Ushtrues detyre i Drejtorit të Përgjithshëm



Ibrahim Gjylderren, Asistent Auditor i Përgjithshëm;



Qerkin Morina, Asistent Auditor i Përgjithshëm.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: PARATHËNIE E SHKURTËR PËR ZYRËN E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

ROLI

Auditori i Përgjithshëm është institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. ZAP ndihmon Auditorin e Përgjithshëm, mandati dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë. Që nga shtatori i vitit 2014 zyra udhëhiqet nga ushtruesi i detyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij, Auditori i Përgjithshëm gëzon liri të plotë të ndërmarrë veprimet e duhura në funksion të mandatit të tij. Ai përgjigjet vetëm para Kuvendit.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë tonë nga organizatat të cilat i auditojmë është vendimtare. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm, dhe ligjor; pajtueshmërisë me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht, dhe një kodi të brendshëm për mirësjelljen profesionale.

AKTIVITETI YNË

Ne kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxheto-

re në bazë vjetore, ku përfshihen Kuvendi, Zyra e Presidentit, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura dhe entitete të tjera.

Ne gjithashtu kryejmë Auditime jo-statutore të Performancës. Kjo është në fushëveprimin tonë, por nuk është një kërkesë vjetore e parashikuar me ligj. Këto auditime kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht, dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne raportojmë për auditimet tona tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (KMFP) dhe këto raporte publikohen. Raportet tona përmbajnë rekomandime me qëllimin për të nxitur ndryshim dhe praktika më të mira. Me këtë duam t'i ofrojmë Kuvendit, Qeverisë, dhe Taksapaguesve një shërbim auditimi profesional të bazuar në fakte dhe të integruar.

Me qëllim që të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do të sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase. Ne e bëjmë këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

PROCESI I LLOGARIDHËNIES

Pasqyrat tona Vjetore Financiare (PVF) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik mbi Bazat e Parasë së Gatshme dhe modifikimet e aplikueshme sipas vendimit të Qeverisë. Për të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të bërë auditimin e PVF-ve tona.

Opinionin e auditimit mbi PVF-të e vitit 2014 është përfshirë në Raportin Vjetor të Performancës, së bashku me PVF-të. Në letrën e auditorëve të jashtëm drejtuar menaxhmentit janë përfshirë shkurtimisht rekomandimet si dhe komentet tona ndaj tyre. Në këtë mënyrë ne ua mundësojmë lexuesve të kenë një pamje, pas auditimit, rreth mënyrës se si i kemi përdorur burimet që na janë dhënë dhe rezultatet nga kjo. Raportet janë të publikuara në faqen tonë të internetit¹⁵

Përpos auditimeve të jashtme, edhe auditimet e brendshme të kryera nga njësi për auditim të brendshëm sigurojnë Auditorin e Përgjithshëm që Zyra vepron në pajtueshmëri me ligjet dhe politikat e veta.

KUSH DO T'I VLERËSOJË METODOLOGJITË TONA TË AUDITIMIT?

Ne kemi bërë shumë për të siguruar që të ndjekim praktikën dhe metodologjinë e mira të auditimit. Ne jemi duke zbatuar një kornizë të menaxhimit të cilësisë. Metodologjinë e mira dhe korniza e cilësisë sigurojnë që auditimet tona kryhen në pajtim me standardet¹⁶ e themeluara të praktikës profesionale.

Ne ndjekim sistemin e rregullt ndërkombëtar të kontroleve mbi punën tonë të auditimit; auditimet tona ekzistojnë brenda një kornize rigoroze të standardeve të auditimit, të cilën stafi mëson se si ta përdorë gjatë programit tonë të trajnimit. Pastaj, gjatë një procesi qartësimi, diskutohet me entitetet e audituara për

të gjeturat e auditimit. Në sistemin tonë është ndërtuar rishikimi nga ana e menaxhmentit dhe monitorimi i mëtejshëm bëhet nga një funksion i veçantë në kuadër të Zyrës. Pas kësaj, raportet tona publikohen dhe janë të hapura për ekzaminim. Pastaj fillojnë shqyrtimet dhe diskutimet në Kuvend së bashku me Ekzekutivin rreth rekomandimeve të auditimit.

Përveç kësaj, cilësia e auditimeve tonë vlerësohet nga partnerët dhe/ose organet e jashtme që vlerësojnë dhe monitorojnë marrëveshjet mes Kosovës dhe BE-së.

KUSH DO TË RISHIKOJË FINANCIJIMIN TONË?


Si Auditor i Përgjithshëm, unë – përveç këtij Raporti Vjetor të Performancës që fokusohet në mënyrën se si është shpenzuar buxheti i Zyrës së Auditimit – do të përgatis dhe dorëzoj çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të më drejtohen mua për të shpjeguar kërkesën buxhetore për Zyrën dhe për të diskutuar raportin tonë mbi planet dhe prioritetet, objektivat e performancës, raportin tonë vjetor të performancës, dhe praktikën tona të menaxhimit.

Qeveria inkorporon kërkesën time buxhetore në Buxhetin e propozuar të Kosovës dhe mund të jap komente për të në një dokument të veçantë. Buxheti i zyrës miratohet nga Kuvendi.

¹⁵ <http://oag.rks-gov.net>

¹⁶ ISSAI, International Standards of Supreme Audit Institutions përcaktojnë parakushtet themelore për funksionimin e duhur dhe sjelljen profesionale të institucioneve të tilla: www.issai.org

ORGANIZIMI I ZAP 2014/15



SHTOJCA 2: PASQYRAT VJETORE FINANCIARE PËR VITIN 2014 DHE ADRESIMI I REKOMANDI- MEVE PËR VITIN 2013

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2014

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Pasqyra e pranimëve dhe pagesave të parave të gatshme
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014

Pasqyra e Pranimëve dhe Pagesave të Parave të Gatshme

| Shënim | 2014 | | 2013 | | 2012 | |
|-------------------------------------|---------------------------------------|----------------------------|---------------------------------------|-----------------------------|---------------------------------------|-----------------------------|
| | Llogaria e Vetme e Thesarit BKK | Pagosa me palët e treta | Llogaria e Vetme e Thesarit BKK | Pagosa nga palët e treta | Llogaria e Vetme e Thesarit BKK | Pagosa nga palët e treta |
| | Euro 000* | Euro 000* | Euro 000* | Euro 000* | Euro 000* | Euro 000* |
| PRANIMET | | | | | | |
| Granti Qeveritar | 1 | 2,112 | 1,985 | - | 1,815 | - |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | 2 | 57 | 21 | 7* | 7 | 7 |
| Totali i Pranimëve | | 2,169 | 2,006 | 7 | 1,822 | 7 |
| Pagesat | | | | | | |
| Operacionet | | | | | | |
| Pagat dhe Mëditjet | 3 | 1,480 | 1,268 | - | 1,174 | - |
| Mallrat dhe Shërbimet | 4 | 644 | 614 | 7 | 561 | 7 |
| Shërbimet Publike | 5 | 27 | 29 | - | 32 | - |
| | | 2,151 | 1,911 | 7 | 1,767 | 7 |
| Transferet dhe Subvencionet | 6 | - | 75 | - | - | - |
| Slipenzimet Kapitale | 7 | 18 | 20 | - | 55 | - |
| Totali i Pagesave | | 2,169 | 2,006 | 7 | 1,822 | 7 |



Artan Venhari
Zëvendës Auditor i Përgjithshëm



Faqe 11/12
